

VENDIM
Nr. 186, datë 7.8.2025

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 112, DATË 23.5.2025, “MBI LLOGARITJEN E PAGESAVE RREGULLATORE PËR VITIN 2025”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.8.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2257 prot., datë 1.8.2025, të drejtorive teknike të ERE-s “Mbi licencën për prodhimin e energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Ujësjiellës-Kanalizime Korçë’ sh.a., me vendimin e Bordit nr. 101, datë 7.11.2014, dhe pagesën përkatëse të rregullimit”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Ujësjiellës-Kanalizime Korçë” sh.a. është licencuar me vendimin e Bordit nr. 101, datë 7.11.2014, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 1 mw, për një afat 30-vjeçar dhe është mbajtëse e licencës nr. 249, seria PVF14.

- Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112, datë 23.5.2025, b“Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2025”, otuar në Fletoren Zyrtare nr. 105, datë 17.6.2025, janë përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2025 për subjektet e licencuara në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Gjatë dërgimit të faturave të fiskalizuara për çdo subjekt është konstatuar se shoqëria “Ujësjiellës-Kanalizime Korçë” sh.a. ka transferuar të gjithë veprimtarinë e saj ekonomike, është çregjistruar dhe nuk ka më personalitet juridik, ndaj me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 185, datë 7.8.2025, është vendosur të shfuqizohet vendimi i Bordit të ERE-s nr. 101, datë 7.11.2014, me anë të të cilit është miratuar licenca e prodhimit të energjisë elektrike për shoqërinë.

- Duke qenë se kësaj shoqërie, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112, datë 23.5.2025, të ndryshuar, i është caktuar pagesa rregullatore për vitin 2025, dhe për sa kohë që ERE nuk ishte vënë në dijeni nga i licencuari, mbi faktin se shoqëria nuk ekzistonte më si person juridik, në kushtet kur kjo shoqëri është çregjistruar, rezulton e pamundur që të shlyhet detyrimi përkatës.

- Në këto kushte, duke qenë se me vendimin nr. 185, datë 7.8.2025, bordi i ERE-s vendosi shfuqizimin e vendimit nr. 101, datë 7.11.2014, për licencimin e shoqërisë “Ujësjiellës-Kanalizime Korçë” sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 1 mw, dhe për pasojë, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e miratuar bëhet e pavlefshme, vlerësohet i domosdoshëm anulimi i pagesës rregullatore për vitin 2025.

- Për sa më sipër dhe në referencë të parashikimeve të metodologjisë përkatëse për përcaktimin e pagesave rregullatore, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 10.8.2020, kjo do të korrigjohet në përcaktimin e pagesave rregullatore vijuese për vitin 2026.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Në tabelën I të vendimit nr. 112, datë 23.5.2025, i ndryshuar, hiqet emri i subjektit “Ujësjiellës-Kanalizime Korçë” sh.a. dhe anulohet pagesa rregullatore për vitin 2025 për këtë subjekt.

2. Diferencat lidhur me përllogaritjen e pagesës rregullatore për të gjithë shoqëritë e licencuara, të cilat janë subjekt të vendimit nr. 112, datë 23.5.2025, “Mbi përllogaritjen e pagesave rregullatore të vitit 2025”, i ndryshuar, do të korrigjohen në llogaritjen e pagesës rregullatore të periudhës pasardhëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti